



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3269/12 prot.

Datë 19.02.2026

V E N D I M
Nr.286/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.02.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të KPP nr. 192/2026, datë 03.02.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me nr. REF-64104-10-08-2025, me objekt: “Ndërtimi i infrastruktures së modeleve të integruara në zona me potencial zhvillimi, Divjakë: “Ferma e dijes dhe agroturizmit të ullishteve, Divjakë”, me fond limit 458,267,729.76 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Z D R A V A” SHPK, me NIPT J84003411K, dhe adresë: Autostrada Lushnje-Fier km 4, Pasuria me nr 104/20 në zonën kadastrale 3, Lushnje.
- Autoriteti Kontraktor:** Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Adresa: Rruga “Sami Frashëri”, nr. 10, Tiranë.
- Subjekte të interesuar:** Operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK, me NIPT J91915001P dhe adresë : Lagjia Zall - Mner i Ri, Rruga Nacionale Kamez, 1054, Tiranë.
- Operatori ekonomik “Ndregjoni” SHPK, me NIPT K31329048I dhe adresë: Njesia Bashkiake Nr. 8, Rruga Sule Bega, Nderresa Nr. 32, Hyrja 8, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:**I***Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datën 03.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.192/2026 ku vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Zdrava” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur”, me nr. REF-64104-10-08-2025, me objekt: “Ndërtimi i infrastruktures së modeleve të integruara në zona me potencial zhvillimi, Divjakë: “Ferma e dijes dhe agroturizmit të ullishteve, Divjakë”, me fond limit 458,267,729.76 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.*
2. *Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik “Ndregjoni” SHPK dhe operatori ekonomik “Almo Konstruktion” SHPK, sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.*
3. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë Komisionin e Prokurimit Publik mbi zbatimin e vendimit duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Zdrava” SHPK*
5. *Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. .

I.2. Me shkresën nr. 192/3 prot., datë 17.02.2026 protokolluar me tonën nr. 3269/9 prot., datë 19.02.2026 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.192/2026 datë 03.02.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me nr. REF-64104-10-08-2025, me objekt: “Ndërtimi i infrastruktures së modeleve të integruara në zona me potencial zhvillimi, Divjakë: “Ferma e dijes dhe agroturizmit të ullishteve, Divjakë”, me fond limit 458,267,729.76 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II**Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1 Me shkresën nr. 192/3 prot., datë 17.02.2026 protokolluar me tonën nr. 3269/9 prot., datë 19.02.2026 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.192/2026 datë 03.02.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me nr. REF-64104-10-08-2025, me objekt: “Ndërtimi i infrastruktures së modeleve të integruara në zona me potencial zhvillimi, Divjakë: “Ferma e dijes dhe agroturizmit të ullishteve, Divjakë”, me fond limit 458,267,729.76 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi veprimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, lidhur me zbatimin e vendimit Nr.192/2026 datë 03.02.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga ky verifikim rezultoi se, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësim të procedurës object ankimi, në zbatim të vendimit Nr.192/2026 datë 03.02.2026, të këtij komisioni.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur”, me nr. REF-64104-10-08-2025, me objekt: “Ndërtimi i infrastruktures së modeleve të integruara në zona me potencial zhvillimi, Divjakë: “Ferma e dijes dhe agroturizmit të ullishteve, Divjakë”, me fond limit 458,267,729.76 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

